



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
ZHVILLIMIT TË BROADBAND**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2018

Lënda: Informacion mbi poseduesin e domain-it ebanking.al

SHOQATËS “MIKROFINANCA SHQIPTARE”

Tiranë

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), bazuar nenin 8, të Ligjit Nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si administrues i domain-it cc.TLD.al, nëndomain-et e tij, si edhe ENUM, ju bën me dije se ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj, Nr. Prot. 200 datë 18.01.2018 “Kërkesë Informacioni”.

AKEP, në zbatim të Ligjit nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” dhe të Rregullores Nr. 2, datë 21.02.2008, “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën .AL etj.”, ju informon si më poshtë:

Domain-i: **ebanking.al** është regjistruar më datë: **20.7.2017** dhe skadon më datë: **20.7.2018**

Posedues: [REDAKTUAR] me status **Person Natyror**

Adresa postare: [REDAKTUAR]

Përsa i përket kërkesës suaj në lidhje me mundësinë e pezullimit apo heqjes të seksionit që shpërndan informacione jo të sakta e dëmtuese të aktivitetit të anëtarëve tuaj, ju informojmë se sipas pikës 1 të nenit 2 të ligjit nr.9918/2008, i ndryshuar “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP nuk merret me përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike. Pra, AKEP e ka të pamundur të ndërhyj për pezullimin e seksionit që shpërndan informacione jo të sakta.

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë ka autorizuar për veprimet e mbylljes së aksesit të faqeve të internetit me përmbytje të paligjshme Autoritetin Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kompjuterike (AKCESK).

AKCESK në zbatim të pikës 3, gërma g) të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.766, datë 14.09.2011 ndryshuar me Vendim nr. 482, datë 16.07.2014 “Për një shtesë në vendimin nr.766, datë 14.09.2011, të Këshillit të Ministrave” dhe Rregullores “Për Administrimin e Portalit Online për mbylljen e aksesit të faqeve të internetit me përmbytje të paligjshme”:

“ngre, administron dhe mirëmban portalin online që do t’u shërbejë personave juridikë publikë dhe privatë, për të publikuar adresat e faqeve të Internetit me përmbytje të paligjshme në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre, si dhe ofruesve të shërbimit të aksesit në Internet (ISP-ve) për marrjen e informacionit me qëllim mbylljen e aksesit në këto faqe sipas legjislacionit në fuqi.”

Sa më sipër AKEP ju rekomandon se për vlerësimin e përmbytjes dhe mbylljen e faqes online ebanking.al, i cili nga verifikimet tuaja ofron përmbytje me informacione jo të sakta, duhet ti drejtoheni Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kompjuterike (AKCESK).

K R Y E T A R